



BULETIN



RRITJA E PJESËMARRJES SË PUBLIKUT NË PROCESIN LEGJISLATIV

Buletin informativ / Nr.27

Dhjetor 2005

Projekt i Qendrës së Studimeve Parlamentare dhe Programit të Drejtësisë, Fondacioni Shoqëria e Hapur (SOROS)

NGA PUNIMET E KUVENDIT PËR MUAJIN NËNTOR 2005

1. P/ligji “Për prodhimin, grumbullimin, përpunimin dhe tregtimin e qumështit dhe të produkteve me bazë qumështi (miratuar në seancë plenare më datë 11.11.2005)

Projektligji është nismë e Këshillit të Ministrave dhe synon hartimin e kuadrit ligjor në fushën e prodhimit, grumbullimit dhe të tregtimit të qumështit dhe të produkteve me bazë qumështi. Duke u nisur nga fakti që mbi 90 për qind e sasisë së qumështit në zonat urbane tregtohet i papasterizuar, në shishe plastike, drejtpërdrejt nga fshatarët ose nga tregtarët e vegjël, në mënyrë krejtësisht të pakontrolluar, projektligji synon të zgjidhë këto probleme me ndikim mjaft negativ tek kon-

(Vijon në faqen 2)

Në këtë numër do të lexoni:

11. Nga Punimet e Këshillit të Ministrave për muajin nëntor 2005 *faqe 1*

2. Nga Punimet e Kuvendit për muajin nëntor 2005 *faqe 1-3*

3. Kalendari 3 javor i Kuvendit të Shqipërisë *faqe 4-5*

Nga Mbledhjet e Këshillit të Ministrave Nëntor 2005

I. Mbledhja e Këshillit të Ministrave e datës 2.11.2005

VENDIME TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE

1. Për një shtesë në vendimin nr. 439, datë 4.8.2000, të Këshillit të Ministrave, Për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.
2. Për shpalljen e zonës shqiptare të liqenit të Shkodrës “Rezervat natyror i manaxhuar”.
3. Për shpalljen e kompleksit ligatinar të liqenit të Shkodrës e të zonës së lumit Buna zonë natyrore veçanërisht e mbrottur dhe përfshirjen e tij në listën e ligatinateve me rëndësi ndërkombëtare, veçanërisht si habitate të shpendëve ujorë.
4. Për shpalljen e lumit Buna dhe të territoreve ligatinore përreth tij “Peisazh ujor tokësor i mbrojtur”.
5. Për shpallejn e kompleksit ligatinor të Butrintit Park Kombëtar
6. Për miratimin, në parim, të marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar 1992, për projektin “Rritja e fondit të investimeve sociale ADF- II”.
7. Për propozimin Kuvendit të Republikës së Shqipërisë emërimin e anëtarit të këshillit drejtues të entit Rregullator të Telekomunikacioneve.
8. Për lejimin e KESH sh.a-së, të përdorë procedurën “ Prokurim i drejtëpërdrejtë”, për blerje të energjisë elektrike, për periudhën nëndor-dhjetor 2005.
9. Për disa ndryshime në vendimin nr 207, datë 28.4.1999, të Këshillit të Ministrave, “Për ndarjen dhe ristrukturimin institucional të Fondit të Zhvillimit Shqiptar”, të ndryshuar.
10. Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 205, datë 13.4.1999, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e dispozitave zbatuese të Kodit Doganor”.

NGA PUNIMET E KUVENDIT PËR MUAJIN NËNTOR 2005

(Vijon nga faqja 1)

sumatori, duke vendosur nën kontrollin ligjor përdorimin për ushqim të qumështit dhe të produkteve me bazë qumështi dhe rritjen e cilësisë së këtyre produkteve për eksport.

Gjatë diskutimit në Komisionin për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin dhe në seancë plenare deputetët e konsideruan pozitive këtë nismë ligjvënëse, e cila do t'i shërbejë rritjes së sigurisë së konsumatorit, nëpërmjet rritjes së cilësisë së qumështit që tregtohet, do të përshtasë legjislacionin tonë me atë të vendeve të BE-së dhe me Marrëveshjet e Tregtisë së Lirë që janë nënshkruar midis vendit tonë me vendet e rajonit.

Diskutimi u përqëndrua në faktin se projektligji parashikon që përmirësimi cilësor i prodhimit dhe i tregtimit të qumështit dhe rritja e sigurisë së konsumatorit për qumështin dhe për produktet me bazë qumështi të bëhet gradualisht. Në projektligj parashikohet nga njëra anë që qumështi, lëndë e parë, të mos lejohet të tregtohet për konsum njerëzor i papërpunuar termikisht, ndërsa nga ana tjetër i lihet hapësirë prodhuesve ose tregtarëve që e shesin qumështin drejtpërdrejt nga ferma tek konsumatori për ta shitur atë të papërpunuar. Deputetët ishin të mendimit se ky lloj gradualiteti bie ndesh me direktivat e BE-së, si dhe me Marrëveshjet e Tregtisë së Lirë, në të cilat disa produkte me bazë qumështi janë objekt koncesionesh për eksport.

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin vendosi që të bëjë ndryshimin e nevojshëm për mënjanimin e kësaj hapësire ligjore, duke theksuar në projektligj se qumështi, lëndë e parë, lejohet të tregtohet vetëm kur i është nënshtruar një përpunimi termik në qëndrat e pajisura me leje për këtë qëllim.

Në këtë Komision u propozuan edhe disa ndryshime të tjera që synonin të përmirësonin përmbytjen e projektligjit.

Në përfundim të diskutimit, projektligji u miratua në seancë plenare, duke mbështetur vërejtjet e propozuara nga Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.

2. P/ligji “Për disa ndryshime në ligjin nr.8669, datë 22.5.2003 “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”, miratuar në seancë plenare më datë 17.11.2005

Ndryshimi kryesor që i bëhet projektligjit është përcaktimi i kategorive të personaliteteve shtetërore vendase dhe të huaja të cilat ruhen dhe mbrohen nga Garda e Republikës së Shqipërisë. Personalitetet e larta shtetërore që do të ruhen dhe mbrohen me ligj përcaktohen në ligj, ndërsa kategoria tjetër e personaliteteve shtetërore që duhen ruajtur dhe mbrojtur është në kompetencë të Këshillit të Ministrave. Qëllimi i këtij ndryshimi është zvogëlimi i numrit të punonjësve të Gardës së Republikës të Shqipërisë, gjë që do të ndikojë në uljen e shpenzimeve për mbajtjen e këtij insititucioni.

Një ndryshim tjetër është vlerësimi i rasteve të ruajtjes ose jo të personaliteteve të huaja. Sipas ligjit ekzistues, kompetenca për vlerësimin e ruajtjes ose jo të personaliteteve të huaja i ishte lënë Këshillit të Ministrave, ndërsa në projektligj kjo kompetencë i kalon Ministrit të Brendshëm. Qëllimi i këtij ndryshimi është rritja e operativitetit, për shkak të kohës së pamjaftueshme që nga njoftimi i vizitës së personalitetit të huaj, deri në mbërritjen e tij, e cila mund të mos mjaftojë për të pritur mbledhjen e radhës të Këshillit të Ministrave.

Gjatë diskutimit deputetët e mazhorancës e mbështetën projektligjin dhe e quajtën të arësyeshme këtë nismë ligjvënëse.

Deputetët e opozitës i kundërshtuan propozimet e Këshillit të Ministrave për ndryshime në ligjin ekzistues. Ata theksuan se projektligji prek pavarësinë e institucioneve kushtetuese të pararura, siç janë institucionet gjyësore, Prokuroria e Përgjithshme etj, pasi ai ia le Këshillit të Ministrave kompetencën për ruajtjen dhe mbrojtjen e titullarëve të këtyre institucioneve.

Gjithashtu, ata u shprehën kundër kompetencës së Ministrit të Brendshëm për vlerësimin e rasteve të ruajtjes së personaliteteve të huaja.

(Vijon në faqen 3)

NGA PUNIMET E KUVENDIT PËR MUAJIN NËNTOR 2005

(Vijon nga faqja 2)

Deputetët e mazhorancës argumentuan efektin pozitiv të këtyre ndryshimeve, veçanërisht për shkurtimin e shpenzimeve.

Në përfundim të diskutimit, projektligji u miratua me shumicë votash.

3. Mocion me debat dhe miratimi i Rezolutës për gjendjen e korrupsionit në vend, paraqitur nga grupi parlamentar i PD-së (zhvilluar në seancë plenare në datat 14 dhe 15 nëntor 2005).

Me kërkesë të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, Kuvendi zhvilloi debat për gjendjen e korrupsionit në vend dhe për përcaktimin e detyrave shtetërore për ta luftuar atë.

Gjatë diskutimit të gjithë deputetët e dënuan ashpër korrupsionin, duke e konsideruar atë si armikun më të madh të shtetit ligjor në Shqipëri dhe si një ndër pengesat kryesore në procesin e integritimit euroatlantik të vendit, si dhe shprehën angazhimin e tyre për denoncimin dhe ndëshkimin e këtij fenomeni.

Deputetët e mazhorancës, duke iu referuar Raportit më të fundit të "Transparency International", i cili e radhit Shqipërinë në vendin me shkallën më të lartë të korrupsionit në Europë, si dhe përkeqësimit të treguesve të korrupsionit gjatë vitit 2005, bënë përgjegjëse Qeverinë e mëparshme për këtë fenomen. Ata ishin të mendimit se Qeveria socialiste jo vetëm nuk e kishte luftuar fenomenin e korrupsionit, por ishte shndërruar në një faktor të rritjes së tij, e mbështetur dhe nga institucionet shtetërore. Duke sjellë shembuj të shumtë, ata vunë në dukje implikimin e vetë zyrtarëve dhe të funksionarëve të lartë në aferat e korrupsionit.

Deputetët e opozitës theksuan se korrupsioni e ka bazën në keqqeverisjen pesëvjeçare të PD-së. Ata përmendën dhe vlerësuan përpjekjet e ish-Qeverisë socialiste për ta luftuar këtë fenomen, veçanërisht miratimin e paketës ligjore në luftë kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, mbështetur në legjislacionin e standardeve më të mira ndërkombëtare në këtë fushë. Ata ishin të

mendimit se miratimi i një projektrezolutive për luftën kundër korrupsionit, siç propozohet nga deputetët e mazhorancës, është formal, pasi ka një program Qeverie që vë detyra në këtë fushë, i cili duhet zbatuar.

Në përfundim të diskutimeve të tyre, opozitarët u larguan nga seanca plenare e Kuvendit, ndërsa ky i fundit i vazhdoi punimet dhe, në fund të debatit, miratoi me shumicë votash një projektrezolutë. Në këtë projektrezolutë, ndër të tjera, Kuvendi shpreh vullnetin dhe angazhimin e tij për hetimin institucional dhe për ndëshkimin e shfaqjeve të korrupsionit, angazhohet dhe i kërkon Qeverisë të ndërmarrë nisma konkrete për përmirësimin e kuadrit ligjor për ndëshkimin e veprave penale në fushën e korrupsionit dhe të shpërdorimit të detyrës, të dërgojë në Prokurorinë e Përgjithshme të gjitha denoncimet që lidhen me korrupsionin e titullarëve dhe të zyrtarëve shtetërorë, i kërkon Prokurorisë të rrisë shkallën e reagimit institucional për luftën ndaj këtij fenomeni, gjithashtu vë disa detyra për organet e sistemit gjyqësor, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, të Inspektoratit të Lartë të Verifikimit të Pasurive dhe të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

KALENDAR I

3 Javor (5 – 28 dhjetor 2005) i Punimeve të Kuvendit

E Hënë, datë 5.12.2005, ora 17.00

-Seancë Plenare

1. Diskutime për çështje që nuk janë në rendin e ditës (deri 60 minuta).
2. Miratimi i proces-verbalit të Seancës Plenare, të datës 1.12.2005.
3. Miratimi i Kalendarit të Punimeve të Kuvendit për periudhën 1-28 Dhjetor 2005.
4. P/Ligji "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8811, datë 17.05.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë".
5. **Për Votim:** Propozimet për emërimin e Inspektorit të Përgjithshëm të Bankës së Shqipërisë.

Për shqyrtimin dhe miratimin e projektligjit "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006" dhe të projektligjeve financiare që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me të:

1. Njoftimi nga Kryetarja e Kuvendit në seancë plenare për paraqitjen në Kuvend të projektligjit "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006" dhe të projektligjeve financiare që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me të.

Datë 1.12.2005

2. Paraqitja në Konferencën e Kryetarëve e projektligjit "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006" dhe e projektligjeve financiare që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me të.
- Miratimi nga Konferenca e Kryetarëve i programit të punës së Kuvendit për shqyrtimin e projektligjit "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006" dhe të projektligjeve financiare që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me të.

Datë 2.12.2005, ora 10.00

3. Shqyrtimi nga komisionet e përhershme të Kuvendit i projektligjeve financiare që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me projektbuxhetin e shtetit të vitit 2006 në parim dhe dorëzimi i raporteve në Komisionin për Ekonominë dhe Financat.

Nga data 2-5.12.2005

4. Shqyrtimi nga Komisioni për Ekonominë dhe Financat i projektligjeve financiare që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me projektbuxhetin e shtetit të vitit 2006 në parim.

Brenda datës 6.12.2005

5. Shqyrtimi në seancë plenare i projektligjeve financiare që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me projektbuxhetin e shtetit të vitit 2006 në parim.

E Hënë, datë 12.12.2005, ora 10.00

6. Shqyrtimi nga komisionet e përhershme të Kuvendit i projektligjit "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006" në parim dhe dorëzimi i raporteve në Komisionin për Ekonominë dhe Financat.

Brenda datës 8.12.2005

7. Shqyrtimi nga Komisioni për Ekonominë dhe Financat i projektligjit "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006" në parim.

Brenda datës 16.12.2005

8. Shqyrtimi nen për nen dhe në tërësi nga komisionet e përhershme të Kuvendit i projektligjeve financiare që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me projektbuxhetin e shtetit të vitit 2006 dhe dorëzimi i raporteve në Komisionin për Ekonominë dhe Financat.

Brenda datës 9.12.2005

9. Shqyrtimi nen për nen dhe në tërësi nga Komisioni për Ekonominë dhe Financat i projektligjeve financiare që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me projektbuxhetin e shtetit të vitit 2006.

Brenda datës 10.12.2005

10. Shqyrtimi i projektbuxhetit të vitit 2006 për Kuvendin nga Sekretariati për Buxhetin.

Brenda datës 15.12.2005

11. Miratimi nga Byroja e Kuvendit i projektbuxhetit të Kuvendit për vitin 2006.

Brenda datës 20.12.2005

12. Shqyrtimi në seancë plenare i projektligjit "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006" në parim.

Datë 19-20.12.2005

13. Shqyrtimi në seancë plenare nen për nen dhe në tërësi i projektligjeve financiare që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me projektbuxhetin e shtetit të vitit 2006.

E Mërkurë, datë 21.12.2005

14. Shqyrtimi nga komisionet e përhershme të Kuvendit nen për nen dhe në tërësi i projektligjit "Për Bux-

(vijon në faqen 5)

KALENDARI 3 JAVOR I PUNIMEVE TË KUVENDIT

(Vijon nga faqja 4)

hetin e Shtetit të vitit 2006" (përfshirë edhe projekt-buxhetin për institucionet e pavarura) dhe dorëzimi i raporteve në Komisionin për Ekonominë dhe Financat.

Brenda datës 22.12.2005

15. Shqyrtimi nga Komisioni për Ekonominë dhe Financat nen për nen dhe në tërësi i projektligjit "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006" (përfshirë edhe projektbuxhetin për institucionet e pavarura).

Data 23-26.12.2005

16. Shqyrtimi nen për nen dhe në tërësi në seancë plenare i projektligjit "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006".

E Mërkurë, datë 28.12.2005

Shënim:

Mbështetur në Kalendarin e Punës së Kuvendit, komisionet e përhershme të hartojnë programet e punës së tyre për shqyrtimin e projektligjit "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006" dhe të projektligjeve financiare që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me të.

Projektligje të tjera për shqyrtim e miratim:

1. P/Ligji "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike".

-Komisioni për Çështjet Ligjore, Admini stratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

- Komisioni për Ekonominë dhe Financat

2. Aktnormativ nr. 2, datë 10.11.2005 "Për lejimin e KESH, SHA-së, të marrë pjesë në ankandet e blerjes së kapaciteteve transmetuese dhe të energjisë elektrike".

Kom. Përgjegjës: Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

Jep mendim: Komisioni për Ekonominë dhe Financat

3. P/Ligji "Për ratifikimin e marrëveshjes së huasë, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Institutit të Kredisë Shtetërore të Mbretërisë së Spanjës, për projektin e ripërtëritjes së rrjetit elektrik të shpërndarjes, Fier".

-Komisioni për Çështjet Ligjore, Admini stratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

- Komisioni i Jashtëm

- Komisioni për Ekonominë dhe Financat

- Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

4. Aktnormativ nr. 3, datë 23.11.2005 "Për një shtesë në ligjin nr. 7971, datë 26.7.1995 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar.

- Komisioni për Ekonominë dhe Financat

5. P/Ligji "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9235, datë 29.7.2004 "Për kthimin dhe kompensimin e pronës", të ndryshuar".

-Komisioni Përgjegjës: Komisioni i Ekonomisë dhe Financës

6. P/Ligji "Për një ndryshim në ligjin nr. 8580, datë 17.2.2000 "Për Partitë Politike".

-Komisioni Përgjegjës:

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut
E Enjte, datë 15.12.2005, ora 17.00

-Seancë Plenare

1. Diskutime për çështje që nuk janë në rendin e ditës (deri 60 minuta).

2. Miratimi i proces-verbalit të seancës plenare datë 12.12.2005.

3. P/Ligji "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike".

4. Aktnormativ nr. 2, datë 10.11.2005 "Për lejimin e KESH, SHA-së, të marrë pjesë në ankandet e blerjes së kapaciteteve transmetuese dhe të energjisë elektrike".

5. Aktnormativ nr. 3, datë 23.11.2005 "Për një shtesë në ligjin nr. 7971, datë 26.7.1995 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar.

6. P/Ligji "Për ratifikimin e marrëveshjes së huasë, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Institutit të Kredisë Shtetërore të Mbretërisë së Spanjës, për projektin e ripërtëritjes së rrjetit elektrik të shpërndarjes, Fier".

7. P/Vendimi "Për ngritjen e nënkomisionit për çështjet e minorenëve dhe barazinë gjinore pranë Komisionit të Përhershëm Parlamentar për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë.

Denada BRESHANAJ

Koordinatorë Projekti/Project Coordinator

Qendra e Studimeve Parlamentare/
Centre for Parliamentary Studies

Rr. Sami Frasheri, Pall. e Aviacionit, nr.3/15

Tirana-Albania Tel/Fax: +355 4 240 214;

cps@albaniaonline.net;

www.ascdp.org